



**Marrëveshja e Bashkëpunimit
ndërmjet
Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë
dhe
Prokurorisë Federale të Mbretërisë së Belgjikës**

Prokuroria e Përgjithshme e Republikës së Shqipërisë, në vijim referuar si PPSH,

dhe

Prokuroria Federale e Mbretërisë së Belgjikës, në vijim referuar si PFMB,

PPSH dhe PFMB së bashku në vijim të referuara si "Palët",

Nisur nga bashkëpunimi i ngushtë gjyqësor në çështjet penale ndërmjet autoriteteve gjyqësore shqiptare dhe belge për të luftuar krimin e rëndë, trafikimin e paligjshëm dhe pastrimin e parave,

Duke pasur parasysh kuadrin ekzistues dhe të ardhshëm të bashkëpunimit, pra instrumentet dypalëshe të disponueshme dhe të ardhshme ndërmjet Mbretërisë së Belgjikës dhe Republikës së Shqipërisë, si dhe traktatet dhe konventat e Këshillit të Evropës, në të cilat të dyja palët janë anëtare,

Duke marrë parasysh parimet dhe rregulloret e së drejtës ndërkombëtare të njohura botërisht,

Duke njohur nevojën për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ekzistues në nivel strukturor, për të përmirësuar mirëkuptimin e ndërsjellë përmes shkëmbimit të informacionit për sistemet ligjore dhe praktikrat e mira të njëri-tjetrit dhe për të nxitur bashkëpunimin e drejtpërdrejtë ndërmjet të dy institucioneve brenda fushave të tyre përkatëse të kompetencës,

BIEN DAKORT SI MË POSHTË

1. Palët do të bashkëpunojnë në fushën e krimeve të rënda, trafikimit të paligjshëm dhe pastrimit të parave, brenda kompetencave të tyre përkatëse dhe në përputhje me ligjet e tyre kombëtare. Palët synojnë të forcojnë bashkëpunimin e drejtpërdrejtë gjyqësor duke nxitur një qasje të përbashkët për të trajtuar krime të tilla që prekin Shqipërinë dhe Belgjikën.
2. Palët shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë informacionin që rrit bashkëpunimin e drejtpërdrejtë. Të gjitha informacionet përkatëse të kontaktit do të vihen në dispozicion. Të gjitha ndryshimet në këtë informacion do të shkëmbehen brenda një vonese të shkurtër.
3. Palët shkëmbejnë në mënyrë të vazhdueshme të gjithë informacionin përkatës në lidhje me sistemet e tyre ligjore përkatëse. Ky informacion ka të bëjë me legjislacionin në lidhje me inkriminimin, ndjekjen penale dhe dënimin e krimeve të rënda, trafikimin të paligjshëm dhe pastrimit të parave, si dhe me të gjithë informacionin për praktikrat më të mira në këtë fushë. Informacioni ka të bëjë edhe me bërjen palë dhe zbatimin e instrumenteve ndërkombëtare në fushën e bashkëpunimit ndërkombëtar në çështjet penale.
4. Palët zbatojnë me të gjitha përpjekjet e tyre "shkëmbimin spontan të informacionit" në lidhje me çështjet, siç parashikohet në nenin 11 të Protokollit të Dytë Shtesë të Konventës Evropiane për Ndhimën e Ndërsjellë në Çështjet Penale (CETS nr. 182) e 8 nëntorit 2001.

5. Palët, në kuadrin dhe brenda kufijve të kompetencës së tyre, do të marrin të gjitha masat e nevojshme (duke përfshirë konsultimet e mundshme përgatitore për formalizimin e kërkesave për ndihmë) për të lehtësuar ekzekutimin efektiv dhe të shpejtë të çdo kërkesë për ndihmë reciproke në çështjet penale që kanë të bëjnë me krime të lidhura me krime të rënda, trafikimin e paligjshëm dhe pastrimin parave, me kusht që këto kërkesa të autorizohen nga autoritetet kompetente të Palës së kërkuar.

Pa paragjykuar detyrimet për të përdorur kanalet zyrtare të përcaktuara nga marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe të përmendura në hyrje, dhe me synimin për të lehtësuar dhe përshpejtuar bashkëpunimin efektiv, Palët gjithashtu do të shkëmbejnë reciprokisht dhe drejtpërdrejt informacion mbi statusin e ekzekutimit të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike, si dhe arsyet e vonesës ose pamundësisë së ekzekutimit të kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike.

6. Palët do të zhvillojnë konsultime dypalëshe në mënyrë periodike me qëllim që:

- të monitorojë zbatimin e kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në kuptimin e gjerë, të dërguara nga autoritetet gjyqësore të secilës prej dy Palëve tek autoritetet gjyqësore të Palës tjetër;
- të diskutojë/konsultojë për vështirësitë operative që dalin në lidhje me zbatimin e këtyre kërkesave për ndihmë të ndërsjellë juridike në kuptimin e gjerë;
- të koordinojë veprimet e marra për të luftuar krimin transnacional që mund të ketë pasoja në të dy vendet brenda objektit të kësaj Marrëveshjeje, të lidhura veçanërisht me krimet e rënda, trafikimin e paligjshëm dhe pastrimin e parave.

7. Përmirësimi i bashkëpunimit ndërkombëtar ndërmjet Palëve dhe i kësaj Marrëveshjeje.

Qëllimi përfundimtar i konsultimeve periodike dypalëshe është rishikimi, dmth. përmirësimi dhe rafinimi i bashkëpunimit të drejtpërdrejtë gjyqësor

ndërmjet palëve. Si konsultimet periodike ashtu edhe ato ad hoc dhe çdo informacion i shkëmbyer spontanisht duhet të përdoret për të zhvilluar më tej bashkëpunimin ndërmjet Palëve. Kjo është një përpjekje e vazhdueshme. Rezultati i kësaj përpjekjeje është rregullimi i mirë i kësaj Marrëveshjeje.

Çdo vit, Palët do të shqyrtojnë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje dhe do të bëjnë propozime të negociuara reciprokisht për të ndryshuar dhe përmirësuar Marrëveshjen.

8. Palët bien dakord që të dhënat personale dhe të ndjeshme të transmetuara sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoren vetëm për qëllimet e përcaktuara në të, në përputhje me dispozitat e përshkruara në konventat ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Kështu, duke siguruar një standard ekuivalent mbrojtjeje në përputhje me Konventën e Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Personale, datë 28 janar 1981.

9. Për qëllimin e ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, Palët do të caktojnë pikat e mëposhtme të kontaktit për shkëmbimin e informacionit dhe dokumenteve:

Në emër të PPSH:

Departamenti i Marrëdhënieve Juridiksionale me Jashtë
foreign.department@pp.gov.al

Në emër të PFMB:

Seksioni i Bashkëpunimit Ndërkombëtar
sekretariat.international@just.fgov.be

10. Kjo Marrëveshje është hartuar në gjuhën shqipe dhe angleze. Të dy versionet e gjuhëve kanë fuqi të barabartë juridike. Kurdoherë që lindin dallime në interpretim ndërmjet të dy versioneve gjuhësore, Palët do të angazhohen në gjetjen e një interpretimi të përbashkët dhe do ta ndryshojnë këtë Marrëveshje nëse e gjykojnë të nevojshme.

11. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit dhe do të mbetet në fuqi për aq kohë sa është e nevojshme për Palët. Kjo Marrëveshje zëvendëson marrëveshjen e bashkëpunimit ndërmjet Prokurorisë së Përgjithshme të Republikës së Shqipërisë dhe Prokurorisë Federale të Belgjikës, nënshkruar në Bruksel më 10 maj 2011, e cila përfundon në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Nënshkruar në Tiranë, më 7 nëntor 2024,

për Prokurorinë e Përgjithshme
të Republikës së Shqipërisë

Olsian ÇELA
Prokurori i Përgjithshëm



për Prokurorinë Federale
të Mbretërisë së Belgjikës

Ann FRANSEN
Prokurori Federal